



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

10 shtator 2019

C-IV-14-5915

Ankuesi

H.J.

Përfaqësuar nga avokati, Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i NSH “SH”

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 10 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI042-4497, i datës 18 korrik 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 gusht 2014, ankuesi përmes të autorizuarit të tij, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një padi/ankesë kundër Vendimit nr. GJI042-4497, të datës 18 korrik 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për pagat e papaguara, në shumën prej 9,760.00 €, për periudhën kohore 1991–1999, nga NSH “SH”. Ankuesi ka pohuar se në shumicën e ndërmarrjeve, punëtorët shqiptar ishin të zëvendësuar nga refugjatët e pakualifikuar serb nga luftërat, sidoqoftë për shkak të rëndësisë së SH-it, punëtorët me përvojë dhe të kualifikuar janë mbajtur në punë dhe se ishin tri periudha nga 1993 deri më 1999 gjatë së cilës punëtorët nuk ishin paguar. Po ashtu, ankuesi e ka kontestuar edhe zbatimin e nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, nga ana e AL-së. Në mbështetje të

ankesës, ka dorëzuar dokumentet ne kopje si ne vijim: autorizimin për përfaqësim, letërnjoftimin, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 09 dhjetor 2010, listën e pagave të papaguara dhe vendimin e kundërshtuar.

Me 12 prill 2017, e paditura AKP-ja në mbrojtjen e saj, ka pohuar se AL-ja ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë aplikuar saktë dhe se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar zbatohet sipas parashikimeve të rregullores së UNMIK-ut 1999/24, e cila përcakton se ligji i zbatueshëm në Kosovë është ligji i cili ka qenë në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, andaj ligjet të cilat janë miratuar nga parlamenti Jugosllav/Serb, pas datës 22 mars 1989 nuk janë të zbatueshme në Kosovë, përfshirë këtu ndryshimet apo plotësimet e ligjeve që ankuesi i referohet se kanë shfuqizuar Ligjin për Punën e Bashkuar. Sipas të paditurës këtë qëndrim të zbatimit të drejtë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar është konfirmuar edhe nga Kolegji i Ankesave në aktgjykimin AC-I-14-0169 të datës 02 prill 2015. Po ashtu e paditura ka pohuar se afati i parashkrimit nuk e lejon AL-në ta analizojë dhe shqyrtojë në merita rastin.

Me 03 maj 2017, i autorizuari i ankuesit ka parashtruar përgjigje në mbrojtjen e AKP-së, në të cilën ka pohuar se, praktika gjyqësore në Dhomën e Posaçme në disa raste ka marrë qëndrim se AL-ja në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale duke i bazuar vendimet e tyre në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, e cila dispozitë ligjore nuk paraqet ligje të aplikueshëm.

Me 12 qershor 2017, AKP-ja ka parashtruar kundërpërgjigje, në të cilën ka pohuar se nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel për shkak të parashkrimit të pretendimeve të ankuesit. Dispozitat ligjore në lidhje me parashkrimin nuk e lejojnë AL-në që të shqyrtojë çështjen në themel dhe se pretendimet e parashtruesit janë parashkruar në pajtim me Nenin 36.1 dhe 37.4.1 të shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe Nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, GJI042-4497, i datës 18 korrik 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në pajtim me nenet 2.4 dhe 71.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.4 i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e

parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore, dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit për Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës i datës 28 shtator 1989, që të dyja këto ligje nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës. Megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Neni 87 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212 i cili aktualisht është në fuqi, vetëm përcakton se të gjitha kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit 3 vjeçar nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është i zbatueshëm në këtë rast.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashkruar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të pagave të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur

detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën e ka parashtruar lidhur me pagat e pa paguara nga viti 1991 e deri në vitin 1999 në shumë prej 9,760.00 €. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 07 qershor 2011, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkuar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për vitet 1991/1999, është parashkuar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagat e fundit ka arritur në vitin 2002, ankuesi kërkesën e ka parashtruar në muajin qershor të vitit 2011, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore apo se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës pranë AL-së, kështu do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit. Pretendimet e parashtruara në ankesë, gjykata i vlerëson si të pa bazuara dhe pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje. për të iniciuar procedurën gjyqësore, apo për të parashtruar ndonjë kërkesë për borxhin e pretenduar

Prandaj, bazuar në atë çfarë u tha më sipër dhe duke iu referuar nenit 74.4 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet gjyqësore

Parashtruesi i ankesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore, në shumë prej 30.00 € më 07 gusht 2018 dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Aktgjykimi duhet t'i dorëzohet palëve.